



REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr _____ Prot

Elbasan më, ____ .02.2026

NJOFTIM

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Elbasan.

Ju njoftojmë se më datë 02.03.2026 ora 12:00 në sallën e Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan zhvillohet mbledhja e radhës Këshillit Bashkiak Elbasan e thirrur nga Kryetari i Këshillit Bashkiak në bazë të Ligjit 139/2015, neni 53 pika 3), me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së Mbledhjes.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së të muajit Janar 28.01.2026.
3. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Janar 2026.
- 3.1. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin Janar 2026.
4. Për vendosjen në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale Z. Peter Subashi.
5. Për vendosjen në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale Znj. Xhuljeta Balukja.
6. Mbi transferimin e aseteve, nga Bashkia Elbasan, në Shoqërinë Rajonale "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sh.a.
7. Transferim fonde në buxhetin e vitit 2026 dhe periudhën afatmesme 2027-2028, si dhe përdorimi i grantit për performancë.
8. Detajim i grantit të bazuar në performancë, me burim financim i huaj.
9. Shtesë e të ardhurave të trashëguara dhe e shpenzimeve, nga fondet me burim (financim i huaj) në buxhetin e vitit 2026.
10. Monitorimi i buxhetit për 4-mujorin e tretë të vitit 2025 (progresiv vjetor).
11. Mbi miratimin e kontratës së "Shërbimit publik për pranimin, depozitimin, trajnimin e mbetjeve urbane të ngurta të Bashkisë Elbasan", në imjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të ngurta të Qarkut Elbasan midis Bashkisë Elbasan dhe "ECO-ELB sh.a"
12. Për miratimin e pikave, për marrjen e materialeve inerteve, për plotësimin e nevojave të banorëve dhe mirëmbajtjes së rrugëve rurale të Bashkisë Elbasan.
13. Për dhënien e fondit pyjor në përdorim për qëllime argëtimi ,shëndetësore, shoqërore veprimtari turistike kampingje dhe agropylltari.
14. Mbi dhënien në përdorim (rinovim kontrate) të ambjentit që ndodhet në lagjen "Visarion Xhuvani", Rr Rinia, Nr.6 me nr.pasurie 6/82, Z.K 8524, nga Bashkia Elbasan.
15. Për miratimin e përbërjes së Bordit Artistik të Teatrit Skampa, Drejtoria e Artit dhe Kulturës.
16. Për shtyrjen e afatit të pagesës së tarifës për zënien e hapësirës publike.
17. Për një shtesë në VKB Nr.140 datë 27.11.2025 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan".



-
18. Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për automjetet në administrimin e Agjnsisë së Mbikqyrjes dhe Kontrollit.
 19. Miratimi i mbështetjes financiare për transportin e nxënësve të grupmoshës 12-18 vjeç, pjesëmarrës në programin e Qendra TUMO Tirana.
 20. Për miratimin e aplikimit për titullin Elbasani “Qyteti European i Sportit”.
 21. Informacion mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve (aseteve shkollore), për vitin 2025.

Të ndryshme,

Komisionet do të mbledhen ditën e enjte datë **26.02.2026** në orën **11:00** në ambientet e Bashkisë Elbasan, salla e mbledhjes së komisioneve.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

LUTFI LALA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN
KRYESIA

Nr. Ext prot.

Elbasan më 20.02 2026

VENDIM

Nr 2, datë 20.02 2026

MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 17, 56, 57 dhe Rregulloren për Organizmin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Elbasan, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Elbasan, në mbledhjen e datës 20.02 2026.

VENDOSI

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Elbasan, e cila do të mbahet në datën 02.03 2026.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës te çdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë Elbasan, Deputetët e qarkut dhe personat apo /dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT - Lutfi LALA

ZV/KRYETAR I KËSHILLIT – Enrieta Ferra

ZV/KRYETAR I KËSHILLIT - Zamir Muzhaqi

